ç’ishte nxitje, motiv dhe gatishmëri të realizohen këto përkthime. Por edhe sepse këto përkthime në vete e përmbajnë edhe thirrjen drejtuar të gjithëve: “të kuptohemi”... *Ta ndezim dritën* dhe t’i shohim edhe fytyrat e tjera të fjalëve dhe ta kuptojmë njëmend këtë që u tha. Si tek poezia “Ç›më the ti” e Lindita Ahmetit “ti më flet për botën e padukshme / për frymët që lëvizin pullazeve / për bukuritë e fshehta / për gjërat që nuk kanë emër / që nuk i nxë as paskaji i gjuhës / unë të them / a ta ndez dritën”. Sepse të gjitha këto vargje, të botuara në këtë libër në origjinal dhe të përkthyera, nuk përmbajnë veç dashuri, emocione, botë të padukshme, bukuri të fshehura dhe gjëra që s’kanë emër… Por edhe shumë më shumë se kaq.

*

Dhe si përfundim, ashtu si në fillim të këtij teksti hyrës t’i rikujtojmë porositë e Dragi Mihajlovskit… Të mos harrojmë se: “E vetmja gjë që na vjen si bekim në këtë “lojë” të gjatë, të pambarimtë përkthimi është kënaqësia e tekstit. Veç kjo dhe asgjë tjetër sepse mënyra sesi funksionon kjo botë është përkthimore, kurse ai, në mjedisin e tij metonimik nuk rendit tulla në Kullën e Babelit, por e zbërthen gjithnjë e më shumë, e tërheq, e zgjeron horizontalisht, asnjëherë vertikalisht. Ne domosdoshmërisht jetojmë bashkë me Benjaminin, Deridanë, De Manin, Inglintonin, të shtypur nën shtatin e saj të shtrirë horizontalisht me një të qarë të përjetshme (e qara më therëse është e përkthyesëve më të mirë) drejt thelbit të paarritshëm që fshihet në ëndrrën e ndërtimit dhe ngritjes së saj:

е задоволството од текстот. Само ова и ништо друго зашто начинот на кој функционира овој свет е преведувачки, а тој, во својата метонимиска поставеност не ја доградува вавилонската кула, туку сè повеќе ја разградува, ја тегне, ја шири по хоризонтала, никогаш во вертикала. Ние нужно живееме заедно со Бенјамин, Дерида, Де Ман, Иглтон, потиснати под нејзината хоризонтално полегната става во вечен плач (најсилен е на тие што се најдобри преведувачи) по недостижното суштинско што се крие во сонот за нејзиното завршување и исправање: а тоа е смртта на преводот и почетокот на разбирањето.“

На студентите и на сите што бевме вклучени во ова заедничко живеење со современата македонска љубовна лирика, ни се случи задоволство од текстот, обид со зборот да се дофати и недостижното, но и... вистински почеток на разбирањето! Да се надеваме дека оваа книга ќе поттикне љубов и почеток на разбирањето кај многумина.

**проф. д-р Весна Мојсова-Чепишевска**

që paraqet vdekjen e përkthimit dhe fillimin e kuptimit.”

Studentet dhe të gjithë ne që ishim të kyçur në këtë jetesë të përbashkët në lirikën bashkëkohore maqedonase të dashurisë, morëm kënaqësi prej tekstit, u përpoqëm që përmes fjalës të arrijmë edhe të paarritshmen, por edhe…

Filluam njëmend të kuptohemi! Të shpresojmë se ky libër do të nxisë dashuri dhe fillim të të kuptuarit tek shumë të tjerë.

**prof. dr. Vesna Mojsova Çepishevska**

*Përktheu prej maqedonishtes në shqip:*
**Saranda Mehmedi**

## БЛАЖЕ КОНЕСКИ
## (1921 – 1923)

## ВЉУБЕНИ ДЕВОЈКИ

Тие имаат лице нежно осенчено,
Како да паѓа на него сенка од проѕирни лисје,
И лицето неусетно се издолжува.
Тие имаат очи зголемени, замислени и влажни,
Како да се плашат од секоја странична изненада.
Тие го наклонуваат така леко челото
Да го допрат до усните на саканиот
Што им се чинат тогаш како крилца од пеперуга
Застаната на тревка — за миг пред да одлета —
А тревката се наклонува.
Тие ги стрелкаат тогаш в преграб рацете
Очајнички смело, слепо и неминовно
Како весла во разнишано море
Пред кое неволно замижуваме.

Боже, дали вистина некогаш сум го доживеал тоа?

# BLAZHE KONESKI
(1921 – 1923)

## VASHAT E DASHURUARA

Kanë fytyrë butësisht të hijezuar,
Sikur i bie hija e gjetheve të nëpërdukshme,
Dhe fytyra pa rënë në sy zgjatet.
Kanë sy të mëdhenj, të përhumbur dhe të njomë,
Sikur i frikësohen çdo befasie përbri.
E përkulin aq lehtas ballin
Që t'iu prekë buzët e të dashurit
Sa iu bëhet sikur në atë çast janë krahë fluture
Të ndalura në një fije bari – pak para se të fluturojë –
A fija e barit përkulet.
Atëherë i zgjasin duart në përqafim
Dëshpërimisht guximshëm, verbërisht dhe pashmangshmërisht
Si rrema në det të valëzuar
Para të cilit padashur mbyllim sytë.

O Zot, thua ta kem përjetuar me të vërtetë këtë ndonjëherë?

*Përktheu prej maqedonishtes në shqip: Saranda Mehmedi*

## АЦО ШОПОВ
## (1923-1982)

### ЧУДНО ПРАШАЊЕ

Имав две убави години во животот.
Зошто ги загубив?
„Сакај нè", рекоа очите свенливо.
Зошто ги загубив?
Срце, заповедав, биди непроменливо
Зошто измамував?
Среќата ни беше малку необична
и не прилегаше сосема на себе си.
Зошто ја загубив?
Затоа едни нè гледаа прекорно,
други зачудено,
а ти припиена молеше топлина:
„Колку е студено".

Среќата ни беше малку необична
и не прилегаше сосема на себе си,
а имав две убави години во животот.
Зошто ги загубив?

**ACO SHOPOV**
**(1923 – 1982)**

## PYETJE E ÇUDITËSHME

Kisha dy vite të bukura në jetë.
Pse i humba?
“Na duaj”, thanë sytë e venitur.
Pse i humba?
Zemër, urdhërova, bëhu e pandryshueshme
Pse mashtrova?
Fati na ishte pak i çuditshëm
dhe nuk i përshtatej fare vetvetes.
Pse e humba?
Prandaj disa na shikonin qortueshëm,
të tjerët habitshëm,
kurse ti ngjitur për meje luteshe për ngrohtësi:
“Sa ftohtë qenka”.

Fati na ishte pak i çuditshëm
dhe nuk i përshtatej fare vetvetes,
dhe kisha dy vite të bukura në jetë.
Pse i humba?

*Përktheu prej maqedonishtes në shqip: Xhunejda Ademi*

## МАТЕЈА МАТЕВСКИ (1929 – 2018)

### СРЕДБА

I
Останав како цвет без мирис и без прашец
латиците суви на видот
да ги склопам

Еден немирен ветер на времето те однесе
семе на цветот на мојот вид од виножитото
да ја плачам твојата отсутност без корен
долго

II
Сега
сосема ненадејно
од памучните магли на дните
исплови повторно ти невина
а толку мирна
исплови од темните катчиња на сонот
спокојно како брод заплови твоето тело
и ме насели со немири

III
Твоето присуство има големи корени
широки пипала што нуркаат по старата земја
и мојот единствен сон
го вковаат
да не прецути

# MATEJA MATEVSKI
# (1929 – 2018)

## TAKIMI

I
Mbeta si lule pa aromë dhe pa pjalm
të thatat petale të shikimit
t'i mbyll

Një erë e trazuar e motit të barti
farë e lules së llojit tim prej ylberi
të ta qaj mungesën tënde të parrënjë
gjatë.

II
Tash
mjaft papritur
prej reve të pambukta të ditëve
u shfaqe përsëri ti çiltërsi
dhe aq e qetë
nxorre kokën prej shtresave të errëta të ëndrrës
paqësisht si lundër lundroi trupi yt
dhe më dyndi gjithë trazim.

III
Prania jote ka rrënjë të trasha
lastarë të gjerë që zhyten në tokën e vjetër
dhe ëndrrën time të vetme
e mbërthejnë
që të mos vyshket.

*Përktheu prej maqedonishtes në shqip: Emira Ajdari*

## ГАНЕ ТОДОРОВСКИ
## (1929 – 2010)

### ЉУБОВНА

Сакам нoktóва да те сакам
Сакам нoќва да ме сакаш
Сакај нoќва да те сакам
Сакај нoќва да ме сакаш

Ноќва сакам да ме сакаш
Сакам сакам сакам сакам
Ноќва да ме сакаш сакам
сакам ноќва сакам ноќва

Да ме сакаш ноќва сакам
Да ме да ме да ме да ме
Да те сакам ноќва сакам
Да те да те да те да те

Да те сакам да ме сакаш
Сакам ноќва сакај ноќва
Сакањето сакам-сакаш
Најсакано сакање е.

## GANE TODOROVSKI
## (1929 – 2010)

### E DASHUR

Dua sonte të të dua
Dua sonte të më duash
Duaj sonte të të dua
Duaj sonte të më duash

Sonte dua të më duash
Dua dua dua dua
Sonte të më duash
Dua dua sonte dua sonte

Të më duash sonte dua
Të më të më të më të më
Të të dua sonte dua
Të të të të të të të të

Të të dua të më duash
Dua sonte duaj sonte
Të dashurit dua-do
Është dashuria më e dashur.

*Përktheu prej maqedonishtes në shqip: Elvira Memeti*

## ЕВГЕНИЈА ШУПЛИНОВА
## (1930 – 2008)

### ДА СЕ РАЗБЕРЕМЕ

Се плашам да живеам во твојот дом
На новиот тепих љубовта да не ми прокапи во солза,
Рацете да не ми станат бели робинки
Кои со крпата за прав ќе ги бришат само годините.
Се плашам да живеам во твојот дом
Деновите да не ми станат искршени чинии пред нозе
Кои не ќе смеам ни да ги оплакувам.

Ми ги отвори вратите од својот дом
И топлата постела во која животот полека умира
На нашите малечки столчиња сакам само нашите
деца да џагорат.

**EVGENIJA SHUPLINOVA**
**(1930 – 2008)**

## TË KUPTOHEMI

Kam frikë të jetoj në shtëpinë tënde.
Në tapetin e ri dashuria mos më pikojë lot,
Duart mos më bëhen robër të bardhë
që me leckën e pluhurit do t'i fshijnë vetëm vitet.
Kam frikë të jetoj në shtëpinë tënde
Ditët mos më bëhen pjata të thyera para këmbëve
Që nuk do të guxoj as t'i vajtoj.

M'i hapi dyert e shtëpisë së tij
Dhe shtratit të ngrohtë në të cilin jeta vdes ngadalë
Në karriget tona të vockla dua vetëm fëmijët
tanë të bëjnë zhurmë.

*Përktheu prej maqedonishtes në shqip: Anita Latifi*

## АНТЕ ПОПОВСКИ
## (1931 – 2003)

# ЕЛЕМЕНТОТ НА ТВОЈАТА НАСМЕВКА

Во изгревот на твојата насмевка
девојчиња во училишни престилки
излегуваат од геометријата

И патем за дома си прераскажуваат
зошто реките ја напуштат татковината
и зошто Адам ништо не вели од земјата.

Твојот збор во пладнето
како млеко од градите на божица
со кои се задоени ѕвездите,

како синото во соништата,
како меѓу две детски прашања...

Залезот на твојата насмевка
се спушта тихо преку многу ридови
... сè до моето Горчливо Езеро.

# ANTE POPOVSKI
# (1931 – 2003)

## ELEMENTI I BUZËQESHJES SATE

Në agun e buzëqeshjes sate
vashëzat me grykëse shkolle
dalin prej gjeometrisë

Dhe rrugës për në shtëpi ritregojnë
përse lumenjtë e lënë vendlindjen
dhe përse Adami nuk thotë asgjë nga toka.

Fjala yte në mesditë
si qumësht gjiri perëndeshe
me të cilin janë ushqyer yjet,

si e kaltëra nëpër ëndrra,
si mes dy pyetjesh fëmijërore…

Perëndimi i buzëqeshjes sate
lëshohet heshtazi nëpër shumë kodrina
… deri tek im Liqen i Hidhur.

*Përktheu prej maqedonishtes në shqip: Saranda Mehmedi*

## ЈОВАН КОТЕСКИ
## (1932 – 2001)

### АНА

Тогаш ги чешлаше косите и којзнае за кого мислеше
додека ја гледаше бледата сенка на мајка ми
што за три оки брашно клечеше пред нозете на твојот татко.
Јужните ветрови донесоа пролетни води и за нас, Ана
ние го знаеме твоето име и се заљубуваме оти ти
имаш и земја и везени чорапи и широки рамења, Ана
којзнае на кого мислеше додека ги чешлаше косите.
Ќе ја доживеам уште оваа пролет со топол здив
дојден пред твојата кошара што се распаѓа на ветрови
и ќе се молам на земјата како на голема икона
не за твоето здравје, не за твоите широки рамења, Ана
овој ден ќе го запишам со името на сите гладни луѓе
и ќе те отерам преку три зашумени планини, Ана
да ти биде проклето името запишано со три обични букви
пред кои се нишаше бледата сенка на мајка ми
дојдена по три оки брашно, за обичен леб, Ана.

# JOVAN KOTESKI
(1932 – 2001)

## ANA

Asokohe i krihje flokët dhe kush e di për kë mendoje
teksa kundroje hijen e zbehtë të nënës sime
që për tri okë miell gjunjëzohej para këmbëve të babait tënd.
Erërat e jugut sollën ujëra pranverore edhe për ne, Ana
ne e dimë emrin tënd dhe dashurohemi sepse ti
ke edhe tokë edhe çorape të qëndisura edhe supe të gjera, Ana
kush e di për kë mendoje teksa krihje flokët.
Do ta përjetoj edhe këtë pranverë me frymë të ngrohtë
ardhur para ahurit tënd që shpërhapet erërave
dhe do t'i lutem tokës si një ikone të madhe
jo për shëndetin tënd, jo për supet e tua të gjera, Ana
këtë ditë do ta shënoj me emrin e gjithë njerëzve të uritur
dhe do të të zboj pas tre palë malesh shushuritëse, Ana
të qoftë i mallkuar emri i shënuar me tri shkronja të rëndomta
para të cilit luhatej hija e zbehtë e nënës sime
ardhur për tri okë miell, për një kafshatë bukë, Ana.

*Përktheu prej maqedonishtes në shqip: Saranda Mehmedi*

## ДАНИЦА РУЧИГАЈ
## (1934 – 1963)

### НЕ, НЕ ЗБОРУВАЈ

Не, не зборувај за очите
што се исушија

Во нив имаше една птица

Пристапи поблиску
и исцеди ја крвта на розите –
птицата ја убија.

Дојди не плаши се
очите веќе немаат сјај.

Дојди, затоа дојди
и отвори ги сите зелени лисја
нека влезе пролет
птиците на пролет се радуваат.

## DANICA RUÇIGAJ
## (1934 – 1963)

# JO, MOS FOL

Jo, mos fol për sytë
që janë tharë

Në to kishte një zog

Eja më afër
dhe shtrydhe gjakun e trëndafilave –
zogun e vranë

Eja mos u frikëso
sytë më nuk kanë shkëlqim.

Eja, andaj eja
dhe hapi të gjitha gjethet e gjelbërta
le të hyjë pranvera
zogjtë në pranverë gëzohen.

*Përktheu prej maqedonishtes në shqip: Emira Ajdari*

## ПЕТРЕ М. АНДРЕЕВСКИ
## (1934 – 2006)

### ЗАДОЦНЕТА ТАЖАЛЕНКА

1.
Во сите наши царства царица беше
сите за мене те разубавија
за да те сакам колку сите тебе.

2.
Птиците пак се враќаат
меѓу своите крила
(ти страни немаш
со нив да се вратиш)

Тревите пак се качуваат
на повисоки дивини
(некаде те догледувам
и два извори извикувам)

и пак околу селото
јасиките се бркаат
(бре, нашата игра
без нас се повторува)

3.
Во сите наши царства царица беше
сите за мене те разубавија
ниту да те имам
ниту да те немам

## PETRE M. ANDREEVSKI
## (1934 – 2006)

## VAJTIM I VONUAR

1.
Në të gjitha mbretëritë tona mbretëreshë ishe
të gjithë të hijeshuan për mua
që sa të gjithë të të dua.

2.
Zogjtë kthehen prapë
mes krahëve të tyre
(ti anë s'ke
të kthehesh me ta).

Barërat hipin prapë
viseve të egra më të larta
(diku të vë re
dhe thërras dy burime)

dhe prapë rreth fshatit
plepat e egër shushurijnë
(bre, loja jonë
pa ne po përsëritet)

3.
Në të gjitha mbretëritë tona mbretëreshë ishe
të gjithë për mua të hijeshuan
as të të kem
as mos të të kem.

*Përktheu prej maqedonishtes në shqip: Anita Latifi*

## ВЛАДА УРОШЕВИЌ (1934)

### ЉУБОВНИЦИ

Тие проаѓаат низ празните улици
изложени на лошата светлина
што им ги пребарува џебовите како ситен крадец
необично нежни како билка пред каменот
изложени на загубување на недоразбирање
изложени на дождот на изминувањето на времето
разделени од се и сами
и во најголемите турканици
и пак споени со градот во доцните часови
со тој град што ги чека
во своите стапици на осаменоста
Поминуваат сеедно
дали низ празни или полни улици
одминувачи дотолку што помислувате
дека веќе на следниот агол ќе се претворат во чад
изложени на лошите светлини
усвитувајќи ја вечноста во шарени мигови

## VLADA UROSHEVIQ
## (1934)

## TË DASHURUARIT

Kalojnë rrugëve të zbrazëta
te ekspozuar ndaj ndriçimit të dobët
që iu bastis xhepat si hajdut i vogël
çuditërisht të butë si bima para gurit
të ekspozuar ndaj humbjes dhe keqkuptimit
të ekspozuar ndaj shiut ndaj kalimit të kohës
të ndarë nga gjithçka dhe të vetëm
edhe mes turmave më të mëdhaja
dhe prapë të bërë një me qytetin në orët e vona
me atë qytet që i pret
në grackat e tij të vetmisë
Kalojnë njejtë
si nëpër rrugët e zbrazëta edhe nëpër ato plot njerëz
kalimtarë derisa kujtoni
se në këndin e ardhshëm do të shndërrohen në tym
të ekspozuar ndaj ndriçimit të dobët
duke e zdritur përjetësinë me çaste shumëngjyrshe.

*Përktheu prej maqedonishtes në shqip: Saranda Mehmedi*

## МИХАИЛ РЕНЦОВ
## (1936-2024)

# СЕ БУДАМ УПЛАШЕН ОД СВЕТЛИНАТА

Се будам уплашен од светлината
Од моето долго зборување за тебе
Дека имам убав ден кога се будиш
И најубава ноќ кога заспиваш.

Се будам уплашен од светлината
Зашто секое утро си го подредуваш
Музејот од розови шишенца
Со мирис на каранфил
Со капки вода за да се зголеми жедта –
Сладост што заслепува.

А јас беспомошно
Се будам уплашен од светлината
Од моето долго зборување за тебе.

## MIHAIL RENXHOV
## (1936-2024)

### ZGJOHEM I FRIKËSUAR NGA DRITA

Zgjohem i frikësuar nga drita
Nga e folura ime e gjatë për ty
Se kam ditë të bukur kur zgjohesh
Dhe natën më të bukur kur të zë gjumi.

Zgjohem i frikësuar nga drita
Sepse çdo mëngjes e rregullon
Muzeun e shisheve rozë
Me aromë karafilash
Me pika uji që të shtohet etja –
Ëmbëlsi që verbon.

Dhe unë i pafuqishëm
Zgjohem i frikësuar nga drita
Nga e folura ime e gjatë për ty.

*Përktheu prej maqedonishtes në shqip: Merita Jashari*

## РАДОВАН ПАВЛОВСКИ (1937 – 2022)

### БАКНЕЖ ВО ТРЕВА

Тревата на твоето тело
расцутува од мојот јужен ветер
Низ трепки го гледаш моето лице
помешано со облаците
Ти што си жедна змија
Јас оган на усни
Околу себе плетеме
Крепост од треви
Во бура од бели
црвени и црни шамивчиња
Твоите и моите очи
се отвораат и затвораат
Музика од движења и квечерина
а пладне е кога во нас
огнот ја пее својата химна
Ќе се вратиш
со мој знак во телото и душата
и штом ќе најдеш моја сличност
друг ќе љубиш тагувајќи за мене
Вазно на мојот цвет.

## RADOVAN PAVLOVSKI
## (1937 – 2022)

### PUTHJA NË BAR

Bari i trupit tënd
mbin prej jugës sime.
Mes qerpikësh e sheh fytyrën time
të përzier me retë
Ti që je gjarpër i etur
Unë zjarr buzësh
Rreth vetes thurim
Kështjellë bari
Në stuhi prej shamishë të bardha
të kuqe dhe të zeza
Sytë e tu dhe të mi
hapen dhe mbyllen
Muzikë lëvizjesh dhe buzëmbremjeje
kurse mesditë është kur brenda nesh
zjarri e këndon himnin e tij
Ke për t'u kthyer
me timen shenjë në trup dhe në shpirt
dhe sapo të gjesh një ngjajshmëri timen
një tjetër do të dashurosh duke vajtuar për mua
Oh saksi e lules sime!

*Përktheu prej maqedonishtes në shqip: Saranda Mehmedi*

## БОГОМИЛЃУЗЕЛ
## (1939 – 2021)

### ЖЕНА

Од небото врне мојата пот
и паѓа ко капки жешко олово
цврчорејќи врз водата од твоето тело

(О тие очи испиени од кусите ноќи
и потем муграта на твоите колкови!)

Полн сум в светот како смрт
како фрлен кавал лута змија.

# BOGOMIL GJUZEL
# (1939 – 2021)

## GRUAJA

Prej qiellit pikon djersa ime
dhe bie si pikla plumbi të nxehtë
duke çikëluar nëpër ujin e trupit tënd.

(Oh, ata sy të përpirë nga netët e shkurtëra
e mandej nga agu i kofshëve të tua!)

Plot jam botës si mort
si fyell i hedhur tutje gjarpër helmues.

*Përktheu prej maqedonishtes në shqip: Saranda Mehmedi*

# ГОРДАНА МИХАИЛОВА БОШНАКОСКА (1940)

## НА РИДОТ

Од оваа височина градот лежи
разделен пред нас,
а ние се држиме за раце.
Од ова место каде што ластовиците
играат над нашите глави,
ги броиме оџаците
и повторно се враќаме
кон нашите разиграни тревки,
кон онаа ситна пчела
која не е никој друг,
туку јас со моите замислени крилја,
во зашеметените цветови од сонцето.
Во моите запрашени очи
од цветот и прозирниот воздух
што некаде во градската долина
лебди
ја чувствувам твојата рака
како ја милува ситната пчела.

## GORDANA MIHAILOVA BOSHNAKOSKA (1940)

### NË KODRINË

Nga kjo lartësi qyteti shtrihet
ndaras përpara nesh,
ndërsa ne mbahemi për dore.
Nga ky vend ku dallëndyshet
luajnë mbi kokat tona,
i numërojmë oxhaqet
dhe përsëri kthehemi
tek barishtet tona lozonjare,
tek ajo bletë e vogël
që nuk është askush tjetër,
por unë me krahët e mi të përfytyruar,
në lulet e trullosura nga dielli.
Në sytë e mi të pluhurosur
nga lulja dhe ajri i tejdukshëm
që diku në luginën e qytetit
rri pezull
ndjej dorën tënde
se si e përkëdhel bletën e vogël.

*Përktheu prej maqedonishtes në shqip: Xhunejda Ademi*

## РИСТО Ѓ. ЈАЧЕВ
## (1942 – 2019)

### ПО ТВОЕТО ЗАМИНУВАЊЕ

По твоето заминување разбрав:
дека сум затворен во мрежи од облаци

дека сум сам и пламен и зандана
и слепа запалена шума

и матна непроодна вода
и напуштена селска воденица,

меѓу ангели со пресечени крила
дека сум и проповедник

единствен летач кон светлините.

О, по твоето заминување сфатив
дека убаво е да се живее

но дека ќе исчезнам без тебе.

**RISTO GJ. JAÇEV**
**(1942 – 2019)**

## PAS LARGIMIT TËND

Pas largimit tënd kuptova:
që jam i burgosur në rrjetë resh

që jam vetë edhe flakë edhe qeli
edhe pyll i verbër që i ka rënë zjarri

edhe ujë i turbullt i papërshkueshëm
edhe mulli i braktisur fshati,

mes engjëjsh me krahë të prerë
qenkam edhe predikues

i vetmi fluturues drejt dritave.

Oh, pas largimit tënd kuptova
që është bukur të jetohet.

por që kam për t'u zhdukur pa ty.

*Përktheu prej maqedonishtes në shqip: Hamdie Terziqi*

## ВЕЛЕ СМИЛЕВСКИ
## (1949)

### ЕВРИДИКА МУ ПЕЕ НА ОРФЕЈ

Ќе тргнам по тебе
со чекор лесен
каков што немаат мртовците
каков што не би требало да имам
бидејќи сум мртва.
Ќе тргнам по тебе
не заради љубовта
од мене за тебе, од тебе за мене,
ќе тргнам
заради поезијата
за да ти се придружам
во опевањето.
Ќе тргнам по тебе,
со чекор лесен
иако, велат, по тебе тргнала
само мојата глава.
А твојата глава...
А твојата глава...
Орфеј, не врти се!

## VELE SMILEVSKI
## (1949)

# EURIDIKA I KËNDON ORFEUT

Do të të ndjek nga pas
me hap të lehtë
siç nuk e kanë të vdekurit
siç nuk duhej t'a kisha
sepse e vdekur jam.
Do të të ndjek nga pas
jo për hir të dashurisë
time për ty, tënde për mua,
do të të ndjek
për hir të poezisë
për të t'u bashkuar
në këndim.
Do të të ndjek nga pas,
me të lehtin hap,
edhe pse thonë, të ndoqi
vetëm koka ime.
A koka yte…
A koka yte…
Orfe, mos u kthe!

*Përktheu prej maqedonishtes në shqip: Melihane Ismani*

## ВИОЛЕТА ТАНЧЕВА-ЗЛАТЕВА (1968)

### ДОАЃАЊЕТО НА ЉУБОВТА

Никогаш не се знае
кога може да се случи љубовта.
Едноставно, ќе ти дотрча
без да видиш од каде
и ќе те запоседне.
Можеби
не си свежо избањат и избричен
косата ти е малку мрсна
и одамна не си била на депилација.
Таа тоа и го сака!
Ќе те зграби со своите меки канџи
и ќе те стресе
од немирно истопореното
подобелено влакно на темето
до малото ноѓно прсте.
Сигурно ќе дојде без најава
Ја знам јас неа.
Ќе ти ја пресече ногата во одот
ќе ти ја секне мислата недоиз'ртена
и ќе ти ја збукне мозолката во срцето.

Остануваш да се мислиш
дали да ја стиснеш
или трпеливо да почекаш
да узрее.

# VIOLETA TANÇEVA ZLATEVA (1968)

## ARDHJA E DASHURISË

Asnjëherë nuk i dihet
se kur mund të vijë dashuria.
Thjesht, do të arrijë tek ti pa e parë
se nga ka ardhur
dhe do të të zotërojë.
Ndoshta
nuk je e sapolarë dhe e rruar
flokët i ke pak të yndyrshëm
dhe nuk je depiluar një kohë të gjatë.
Ajo këtë do!
Do të të kapë me kthetrat e saj të buta
dhe do të të shkundë
që nga thinjat e ngrefosura trazueshëm
në majë të kokës
e deri tek gishti i vogël i këmbës.
Me siguri do të vijë pa lajmëruar
E njoh unë atë!
Do të ta shkurtojë këmbën duke ecur
do të ta këpusë mendimin pa mbirë mirë
dhe do të ta shpërthejë puçrrën në zemër.

Mbetesh duke u menduar
a t'a shtrydhësh
apo të presësh gjithë durim
të piqet.

*Përktheu prej maqedonishtes në shqip: Elvira Memeti*

## НИКОЛА МАЏИРОВ
## (1973)

### МОЖЕБИ УШТЕ ПАТУВА

Најмила моја.
Во писмото стои
дека се разделив од воздухот.

Ќе прочиташ.
Во третиот ред е подвлечено
со сино мастило
дека се откажав од асфалтот.

И уште нешто.
Ми се чини ти напишав дека
од велосипедот ги извадив
помошните тркала.

Писмото сигурно ќе го добиеш.
Ќе стигне
преку плодните ораници,
закачено за трепките
што ги чувам склопени
поради силниот ветер.

Најмила моја.
Во писмото стои...

## NIKOLA MAXHIROV
## (1973)

# NDOSHTA ENDE ËSHTË RRUGËS

Më e dashura ime.
Në letër shkruan
që u ndava nga ajri.

Do ta lexosh.
Në rreshtin e tretë është e nënvizuar
me ngjyrë të kaltërt
që hoqa dorë nga asfalti.

Edhe diçka tjetër.
Më duket se të shkruajta që
prej biçikletës i hoqa
rrotat ndihmëse.

Letrën do t'a marrësh patjetër.
Do të mbërrijë
përmes fushave pjellore
të varura për qerpikësh

që i ruaj të mbyllura
për shkak të erës së fortë

Më e dashura ime.
Në letër shkruan …

*Përktheu prej maqedonishtes në shqip: Hamdie Terziqi*

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека “Св. Климент Охридски”, Скопје

821.163.3-1(081)

ДА се разбереме [Електронски извор] : љубовни песни од современи македонски поети = Të kuptohemi : poezi dashurie nga poetë bashkëkohorë maqedonas / приредувач Весна Мојсова-Чепишевска ; соработници Иван Антоновски, Саранда Мехмед ; [превод од македонски на албански јазик Џунејда Адеми ... и др.]. - Текст во ПДФ формат, содржи 52 стр., илустр. - Скопје : Универзитет “Св. Кирил и Методиј” во Скопје, Филолошки факултет “Блаже Конески”, 2024

Начин на пристапување (URL): https://flf.ukim.mk/da-se-razbereme-lubovni-pesni/. - Фусноти кон текстот. - Наслов преземен од екран. - Опис на изворот на ден 19.11.2024 год. - Текст на мак. и алб. јазик. - Други преведувачи: Емира Ајдари, Мелихане Исмани, Мерита Јашари, Саранда Мехмеди Анита Љатифи, Елвира Мемети, Хамдие Терзиќи

ISBN 978-608-234-120-0

COBISS.MK-ID 64748805

flf.ukim.mk